Jo, ajo që po të ndodh ty është gjakrrjedhje e çrregullt. Lëre namazin aq ditë sa të janë paraqitur menstruacionet më parë, pastaj laju dhe falu.”

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Fatime bint Hubejshi e pyeti Pejgamberin ﷺ: "Kam gjakrrjedhje të pandërprerë, kështu që nuk po pastrohem. A ta lë namazin?" Profeti ﷺ tha: “Jo, ajo që po të ndodh ty është gjakrrjedhje e çrregullt. Lëre namazin aq ditë sa të janë paraqitur menstruacionet më parë, pastaj laju dhe falu.”
[Sahih] [Muttefek alejhi]

Fatime bint Hubejshi e pyeti Profetin ﷺ dhe i tha: "Gjakrrjedhja ime nuk po ndalet dhe vazhdon edhe kur nuk jam me menstruacione, a e merr kjo gjendje vendimin fetar sikur për menstruacione, e kësisoj gjatë kësaj periudhe ta lë namazin?" Profeti ﷺ i tha: "Ai është gjak i istihadës (gjakrrjedhje e çrregullt - hemorragji); gjak patologjik që rezulton nga ndërprerja e gjakrrjedhjes në mitër dhe nuk është gjak menstrual. Nëse vjen koha e menstruacioneve gjatë së cilës ke pasur menstruacione sipas zakonit tënd mujor, para se të sëmuresh me gjakrrjedhje të çrregullt, atëherë gjatë kësaj kohe lëre namazin, agjërimin dhe gjërat e tjera që femra me menstruacione pengohet t'i bëjë në kohën e menstruacioneve. Kur të kalojë kjo periudhë e të jesh pastruar nga menstruacionet, atëherë pastroje vendin e gjakut, e pastaj laje plotësisht trupin tënd, që ta largosh kështu papastërtinë kuptimore (ar. hadeth), e më pas falu.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3029